



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ISH PROKURORJA ROVENA GASHI KËRKON DY JAVË KOHË PËR TË ZGJEDHUR NJË PËRFAQËSUES LIGJOR. KPA SHTYEN SËRISH SEANCEN.

KPA zhvilloi sot më 23 prill, ora 10:00 seancën e radhës me Rovena GASHIN, ish prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.

Trupi gjykues pasi verifikoi prezencën e palëve (subjektit të rivlerësimit dhe vëzhgueses ndërkombëtare) ia dha fjalën subjektit të rivlerësimit.

Znj. Rovena Gashi kërkoi që në këtë proces të përfaqësohej në bazë të nenit 96 par 1. gërma b) të Kodit të Procedurës Civile nga motra e saj, Ema GASHI, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Durrës. Neni 96 par 1. gërma b) citon “Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë: b) bashkëshortët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe **motrat**”.

Trupi gjykues i përbërë nga Albana Shtylla (kryesuese), Luan Daci (relator), Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo (anëtare) me vendim të ndërmjetëm vendosi të rrëzojë kërkesën e Subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 96 par 2 g. ç) të Kodit të Procedurës Civile i cili citon: “nuk mund të jenë përfaqësues të palëve: ç) **gjyqtarët** dhe prokurorët”.

Sipas kryesuses, Ema Gashi, bazuar në deklaratimet e saj në seancën e mëparshme, ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Durrës për këtë arsye ajo nuk mund të jetë përfaqësuese e palëve në një proces.

Znj. Gashi pasi u njoh me vendimin e ndërmjetëm kërkoi që trupi gjykues t’i japë dy javë kohë për të kërkuar një përfaqësuese ligjore. Sipas subjektit Znj. Ema Gashi është e vetmja që gëzon besimin e saj të plotë dhe se ajo do ta përfaqësonte më mire se çdo kush tjetër gjatë procesit në KPA. Subjekti i rivlerësimit pohoi se motra e saj Znj. Ema Gashi do të japë dorëheqjen në KLGJ për ta përfaqësuar atë në këtë proces.

Trupi gjykues pasi u tërhoq në dhomën e këshillimit me vendim të ndërmjetëm pranoi kërkesën e subjektit për shtyrjen e seancës, e cila do të zhvillohet më 6 maj ora 10.00.

Seanca e sotme u zhvillua në respektim të parimit për një proces të rregullt ligjor. Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPA-së. Seanca ishte e hapur për të interesuarit që mund ta ndiqnin atë pas shënimit të gjeneraliteteve në hyrje.

Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës në seancë, ku u verifikua dhe identiteti i saj.